

Të dhëna bazike të lëndës: Puna Sociale në Shkollë	
Njësia akademike:	Fakulteti Filozofik/Departamenti Punë Sociale
Titulli i lëndës:	Puna Sociale në Shkollë
Niveli:	BA
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	II
Numri i orëve në javë:	2 +1
Vlera në kredi – ECTS:	5 ECTS
Koha / lokacioni:	E Martë, 10:00-11:30, Salla #128
Mësimdhënësja e lëndës:	Prof. Asoc. Vjollca Krasniqi
Detajet kontaktuese:	vjollca.krasniqi@uni-pr.edu
Konsultime	E Martë, 09:00-10:00
Përshkrimi i lëndës:	
	Lënda trajton rolin e Punës Sociale në shkollë. Lënda reflekton mbi konceptin e shkollës sot dhe relacionin me punën sociale. Lënda do të përqendrohet në këto tema: metoda të ndryshme të punës preventive si dhe intervenime (puna me individ, puna në klasa dhe puna në komunitet); etika, politika e arsimit, si dhe raste studimi nga organizimi i projekteve dhe aktiviteteve të ndryshme në shkollë në Kosovë dhe më gjerë.
Qëllimi/Pëmbajtja e lëndës:	
	<ol style="list-style-type: none"> 1. Lënda ofron njohuri rreth punës së punëtores/punëtorit social në shkollë; 2. Aplikimin e metodave të punës sociale në interventimet në shkollë 3. Analizë të çështjeve sociale dhe ndikimin e tyre në shkollë dhe sistemin e arsimit.
Rezultatet e pritura të nxënies:	
	<ol style="list-style-type: none"> 1. Studentët do të jenë në gjendje për të njohur pozicione të ndryshme në debatin akademik për shkollën dhe problemet sociale në shkollë. 2. Studentët do të demonstrojnë një vetëdije kritike të natyrës së shpjegimit të rolit të punës sociale në shkollë 3. Aplikojnë perspektivat e ofruara në studimin e shkollës nga perspektiva e punës sociale. 4. Studentët do të zhvillojnë shkathtësi për intervenime në çështje sociale në shkollë. 5. Studentët do të zhvillojnë mendim kritik për edukim demokratik dhe qytetar. 6. Studentët do të aplikojnë qasje dhe metoda të Punës Sociale në shkollë. 7. Studentët zhvillojnë shkathtësi për ndërveprim mes shkollës, familjes dhe komunitetit.

Kontributi në ngarkesën e studentit/es			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	10
Ushtrime në teren	1	10	10
Kollokfiume, seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	1	7	7
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	8	8
Pregaditja përfundimtare për provim	4	6	24
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	5	5
Projektet, prezentimet, etj.	1	12	12
Total			125 orë
Forma e mësimdhënies:	<p>Mësimi: Ligjërata dy orë dhe një ushtrime. Ligjëratat dhe ushtrimet – do të ofrojnë një forum për eksplorim, debat dhe shkëmbim të ideve për çështjet e trajtuara në literaturë. Nga studentë pritet të kenë lexuar së paku një tekst me qëllim të pjesëmarrjes në diskutim.</p> <p>Puna në lëndë – studentët do të pregadisnin prezantime nga temat e shqyrtuara në këtë lëndë.</p>		
Forma e vlerësimit dhe kriteret:	<p>Vlerësimi – Kjo lëndë vlerësohet nga dy provimi (80%) dhe pjesëmarrja aktive në lëndë (20%).</p>		
Literatura			
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> Tahirsylaj, A. (2021). What kind of citizens? Constructing ‘Young Europeans’ through loud borrowing in curriculum policy-making in Kosovo, <i>Comparative Education</i>, 57(1):115-129. Kelly, M, and Constable, R. (2016). <i>School Social Work: Practice, Policy, and Research</i>, Carol Rippey Massat, Lyceum Books. Dewey, J. (2003 përkthimi). <i>Shkolla dhe Shoqëria</i>. Tiranë: Plejad. Jarolmen, J. (2013). <i>School Social Work: A Direct Practice Guide</i>, Los Angeles & London: Sage. 		

Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Openshaw, L. (2008). <i>Social Work in Schools: Principles and Practice: Clinical Practice with Children, Adolescents, and Families.</i> New York & London: The Guilford Press. 2. Raines, J. C. (2004). Evidence-based practice in school social work: A process in perspective. <i>Children & Schools, 26 (2), 71-85.</i>
---------------------------	---

Plani i dizajnuar i mësimi:

Java	Ligjëratat që do të zhvillohen
<i>Java e parë</i>	Shkolla dhe Shoqëria
<i>Java e dytë</i>	Arsimi gjithëpërfshirës dhe edukimi qytetar
<i>Java e tretë</i>	Politika dhe Sistemi i Arsimit në Kosovë
<i>Java e katërt</i>	Çështjet Sociale në shkollë
<i>Java e pestë</i>	Gjinia dhe Arsimi
<i>Java e gjashtë</i>	Mjedisi shkollor
<i>Java e shtatë</i>	Dhuna në shkollë
<i>Java e tetë</i>	Shkolla, Familja dhe Komuniteti
<i>Java e nëntë</i>	Roli i punëtorit/es social/e në Shkollë
<i>Java e dhjetë</i>	Zgjidhja e Problemeve në Shkollë
<i>Java e njëmbëdhjetë</i>	Udhëheqja dhe qeverisja në Shkollë
<i>Java e dymbëdhjetë</i>	Të drejtat e fëmijëve në arsim
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Puna Sociale Klinike
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Përmbledhje dhe Vlerësimi

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Vijimi – vijimi i lëndës është **i detyrueshëm** për të gjithë studentët e regjistruar në këtë lëndë dhe studentët të cilët nuk kanë vijuar lëndën, normalisht nuk do të iu lejohet dalja në provim. Sipas rregullave të Degës, do të mbahet regjistër i vijimit të lëndës.

Burimet - një kopje e këtij dokumenti dhe informacione tjera të rëndësishme do të iu jepen të gjithëve në hard kopje.

Leximi – për çdo javë nga ju pritet që të lexoni së paku nga një kapitull të librave kryesor në këtë lëndë.